





REPUBLIKA E KOSOVËS

**Komuna Drenas
Zyra e Kryetarit
Drenas, më 11.05.2018**



Nga: Kryetari i Komunës së Drenasit z. Ramiz Lladrovci

Për: Ministrinë e Administrimit dhe Pushtetit Lokal



LËNDA: Dërgimi i akteve të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur më datën 04.05.2018

1. Vendim për subvencionimin e KF "Feronikelit"
2. Vendim për subvencionimin e Këshillit për Veprim Rinor Lokal "KVRL"
3. Vendim për rrënimin e ishujve në Sheshin "Fehmi Lladrovci"
4. Vendim për shfuqizimin e vendimit të komunës nr.421-3587 të datës 19.06.2009, që i ishte dhënë prona komunale në shfrytëzim NTP "FLORIANI" me pronar Muhamet Ajazi nga Komorani
5. Vendim për shfuqizimin e vendimit të komunës nr.421-3587 të datës 19.06.2009, që i ishte dhënë prona komunale në shfrytëzimin NTSH "BE-INDENERING BAU" me pronar Gëzim Gegaj nga Komorani
6. Vendim për kthimin e pronës komunale, të dhënë në shfrytëzim të përhershëm pronarit Hajdar Heta nga Glllogoci
7. Vendim për kthimin e pronës komunale, të dhënë në shfrytëzim të përhershëm pronarit Zejnullah Strumcaku nga fshati Abri e Epërme
8. Vendim për ndarjen e pronës komunale për varrezat e fshatit Korroticë e Ulët
9. Vendim për formimin e komisionit për rregulloren për dekorata dhe mirënjohje
10. Vendim për formimin e komisionit për ndryshimin e Stemës dhe Vulës së Komunës së Drenasit si dhe harmonizimin e statutit të komunë me ligjet në fuqi
11. Vendim për financimin e projektit të HANDIKOS-it.

Drenas,
11.05.2018



**Republika e Kosovës
Komuna e Drenasit (Glllogoc)**



Kuvendi i Komunës
12 Nr. 30/01-2795 dt. 11/05/2018

Nga : Kryesuesi i Kuvendit të Komunës- z. Labinot Halilaj

Për: Kryetarin e Komunës z. Ramiz Lladrovci

LËNDA: Dërgimi i akteve të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur më dt: 04.05.2018

1. Vendim për subvencionimin e KF "Feronikelit".
2. Vendim për subvencionimin e Këshillit për Veprim Rinor Lokal "KVRL".
3. Vendim për rrënimin e ishujve në Sheshin "Fehmi Lladrovci".
4. Vendim për shfuqizimin e vendimit të komunës nr. 421-3587 të datës 19.06.2009, që i ishte dhënë prona komunale në shfrytëzim NTP "FLORIANI" me pronar Muhamet Ajazi nga Komorani.
5. Vendim për shfuqizimin e vendimit të komunës nr. 421-3587 të datës 19.06.2009, që i ishte dhënë prona komunale në shfrytëzimin NTSH "BE-INDENERING BAU" me pronar Gëzim Gegaj nga Komorani.
6. Vendim për kthimin e pronës komunale, të dhënë në shfrytëzim të perhershëm pronarit Hajdar Heta nga Glllogoci.
7. Vendim për kthimin e pronës komunale, të dhënë në shfrytëzim të perhershëm pronarit Zejnullah Strumcaku nga fshati Abri e Eperme.
8. Vendim për ndarjen e pronës komunale për varrezat e fshatit Korroticë e Ulët.
9. Vendim për formimin e komisionit për rregulloren për dekorata dhe mirënjohje.
10. Vendim për formimin e komisionit për ndryshimin e Stemës dhe Vulës së Komunës së Drenasit si dhe harmonizimin e statutit të komunës me ligjet në fuqi.
11. Vendim për financimin e projektit të HANDIKOS-it.

Drenas,
11.05.2018



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



Nr. 400/03-27078 dt. 11/05/ 2018

Duke u bazuar në nenin 11,12 dhe 40 të Ligjit Vetëqeverisjes Lokale nr.03/L-040, nenit 34 pika 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarjen e Subvencioneve dhe Transfereve e miratuar me datë 19.03.2017 nga Kuvendi i Komunës, nr.12-320-19338, të datës 07.04.2017 pastaj Buxheti i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Drenasit për vitin 2018. Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur më datë 04.05.2018 aprovoi këtë:

VENDIM PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT

Neni 1

Me këtë vendim, kërkohet mbështetja financiare për projektin e KF„Feronikeli”. Lidhur me mbulimin e shpenzimeve për sezonin pranveror-vjeshtor 2018, anëtar i superligës së Kosovës.

Neni 2

Projekti i KF„Feronikeli” përkrahet me shumën prej 30.000€ mjetet të cilat do të shfrytëzohen për mbulimin e shpenzimeve të klubit për vitin 2018.

Neni 3

Financimi-Subvencionimi i projektit do të bëhet nga Buxheti i Drejtoratit për Kulturë, Rini dhe Sport nga kategoria ekonomike e shpenzimeve, subvencioneve dhe transfereve, kodi ekonomik 21/611/85001/21200/0000/0820.

Neni 4

Mjetet financiare barten në konton e KF„Feronikeli”. Drejtorati i Kulturës, Rinisë dhe Sportit është e obliguar që për shumën e mjeteve për financimin e përmendur në nenin 2 të këtij propozim vendimi të përcjellë implementimin e projektit, duke kërkuar nga KF„Feronikeli” që të bëjë raport tekstual dhe financiar në mënyrë që të njoftoj DKRS-në për mënyrën e shpenzimeve të mjeteve financiare.

Neni 5

Për zbatimin këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës, Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport.

Neni 6

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmerisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Labiriot Halilaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



012Nr 400/04-27081 dt. 11/05/ 2018

Duke u bazuar në nenin 11,12 dhe 40 të Ligjit Vetëqeverisjes Lokale nr.03/L-040, nenit 34 pika 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarjen e Subvencioneve dhe Transfereve e miratuar me datë 19.03.2017 nga Kuvendi i Komunës, nr.12-320-19338, të datës 07.04.2017 pastaj Buxheti i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Drenasit për vitin 2018. Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur më datë 04.05.2018 aprovoi këtë:

VENDIM PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT

Neni 1.

Me këtë vendim, kërkohet mbështetja financiare për projektin e Këshillit të Veprimit Rinor Lokal në Drenas (KVRL) lidhur me mbulimin e shpenzimeve për zhvillimin e aktivitetit për vitin 2018.

Neni 2.

Projekti i KVRL përkrahet me shumën prej 3.000€ mjetet të cilat do të shfrytëzohen për mbulimin e shpenzimeve për aktiviteteve rinore për vitin 2018.

Neni 3.

Financimi-Subvencionimi i projektit do të bëhet nga Buxheti i DRKS nga kategoria ekonomike e shpenzimeve, subvencioneve dhe transfereve, kodi ekonomik 21/611/85001/21200/0000/0820.

Neni 4.

Mjetet financiare barten në konton e KVRL-së. Drejtorati i Kulturës, Rinisë dhe Sportit është e obliguar që për shumën e mjeteve për financimin e përmendur në nenin 2 të këtij propozim vendimi të përcjellë implementimin e projektit, duke kërkuar nga KVRL që të bëjë raport tekstual dhe financiar në mënyrë që të njoftoj DKRS-në për mënyrën e shpenzimeve të mjeteve financiare.

Neni 5.

Për zbatimin këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës, Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Drejtorati për Kulturë, Rinë dhe Sport.

Neni 6.

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmerisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Labinot Halilaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



12 Nr 354/03-27086 dt. 11/05/ 2018

Duke u bazuar në nenin 11,12 dhe 40 pika 40.2 nën 1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40, nenit 34 pika 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vetë të rregullt më datë 04.05.2018 aprovoi këtë:

V E N D I M
Për rrenimin e Ishujve në Sheshin “Fehmi Lladrovci”

Neni I

Me këtë Vendim, kërkohet që të na lejohet që të bëhët rrenimi ishujve nga betoni në sheshin “Fehmi Lladrovci”.

Neni II

Në vend të ishujve do të bëhët shtrimi me kubza identike si ato ekzistuese.

Neni III

Të gjitha shpenzimet do të kryhen nga Operatori ekonomik që do të bëjë rrënimine tyre.

Neni IV

Ky ndryshim i ishujve në shesh bëhët më qëllim të përshtatjës së ambientit për vendosjen e Shatores së herojve “Fehmi e Xheva Lladrovci”.

Neni V

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmerisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Labinot Halilaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



12 Nr 421/01-2830 dt. 11/05/ 2018

Duke u bazuar në nenin 11,12 dhe 40 pika 40.2 nën 1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40, nenit 34 pika 34,6 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 110 të Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, si dhe në bazë të Raportit Nr. 01-942/04-21953 të datës 18.04.2018 të komisionit profesional për verifikimin e procedurave ligjore të dhënies në shfrytëzim të pronave komunale, për pronën komunale gjegjësisht ngastrën kadastrale Nr.1/2 me kulture tokë ndërtimore në sipërfaqe prej S=0.10.00 ha në vendin "Fusha e gjerë" në zonën kadastrale Komoran, NTP "Floriani" me pronar Muhamet Ajazi nga Komorani, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vetë të rregullt më datë 04.05.2018 2018 aprovoi këtë:

V E N D I M

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 421-3587 TË DATËS 19.06.2009, QË I ISHTE DHENË PRONA KOMUNALE NË SHFRYTEZIM NTP "FLORIANI" ME PRONAR MUHAMET AJAZI NGA KOMORANI

Neni 1

Më këtë Vendim, miratohet Kthimi i Prones Komunale në Zonen Kadastrale në Komoran, që i ishte dhenë në shfrytëzim NTP."FLORIANI" me pronar Muhamet Ajazi nga Komorani, në ngastrën kadastrale Nr.1/2 me kulture tokë ndërtimore në sipërfaqe prej S=0.10.00 ha në vendin "Fusha e gjerë" në zonën kadastrale Komoran, në shfrytëzim të përkohshëm për 10 vite .

Neni 2

Shfuqizohet Vendimi Nr.421-3587 i datës 19.06.2009 i komisionit për dhënie në shfrytëzim të përkohshëm të pronës komunale, me bazë të cilit është lidhur kontrata Nr. 462-4010 e datës 06.07.2009, me të cilat vendim i është dhenë prona komunale në shfrytëzim NTP."FLORIANI" me pronar Muhamet Ajazi nga Komorani, ngastrën kadastrale Nr.1/2 me kulture tokë ndërtimore në sipërfaqe prej S=0.10.00 ha në vendin "Fusha e gjerë" në zonën kadastrale Komoran.

Neni 3

Me këtë vendim do të njoftohet NTP."FLORIANI" me pronar Muhamet Ajazi nga Komorani.

Neni 4

Per zbatimin e këtij vendimi përkujdeset kryetari i Komunes, dhe Drejtoratet përkatëse të komunës së Drenasit.

Neni 5

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmerisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

[Signature]
Labinot Halilaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



12. Nr 421/01-27092 dt. 11/05/2018

Duke u bazuar në nenin 11,12 dhe 40 pika 40.2 nën 1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40, nenit 34 pika 34,6 të Statutit të Komunës së Drenasit, ninit 110 të Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, si dhe në bazë të Raportit Nr. 01-942/04-21953 të datës 18.04.2018 të komisionit profesional për verifikimin e procedurave ligjore të dhënies në shfrytëzim të pronave komunale, për pronën komunale gjegjësisht ngastrën kadastrale Nr.202 dhe 201 me kulture tokë ndërtimore në sipërfaqe prej S=0.40.00 ha në vendin "Fusha e gjerë" në zonën kadastrale Komoran, NTSH."BE-INGENIERINBAU" me pronar Gëzim Gegaj nga Komorani, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vetë të rregullt më datë 04.05.2018 aprovoi këtë:

V E N D I M

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR. 421-3587 TË DATËS 19.06.2009, QË I ISHTE DHENË PRONA KOMUNALE NË SHFRYTEZIM NTSH "BE-INGENIERINBAU" ME PRONAR GËZIM GEGAJ NGA KOMORANI

Neni 1

Më këtë Vendim, miratohet Kthimi i Pronës Komunale në Zonën Kadastrale në Komoran, që i ishte dhenë në shfrytëzim NTSH."BE-INGENIERINBAU" me pronar Gëzim Gegaj nga Komorani, ngastrën kadastrale Nr.202 dhe 201 me kulture tokë ndërtimore në sipërfaqe prej S=0.40.00 ha në vendin "Fusha e gjerë" në zonën kadastrale Komoran, në shfrytëzim të përkohshëm për 10 vite .

Neni 2

Shfuqizohet Vendimi Nr.421-3587 i datës 19.06.2009 i komisionit për dhënie në shfrytëzim të përkohshëm të pronës komunale, me bazë të cilit është lidhur kontrata Nr. 401-6064 e datës 06.07.2009, me të cilat vendim i është dhenë prona komunale në shfrytëzim NTSH."BE-INGENIERINBAU" me pronar Gëzim Gegaj nga Komorani, ngastrën kadastrale Nr.202-201 me kulture tokë ndërtimore në sipërfaqe prej S=0.40.00 ha në vendin "Fusha e gjerë" në zonën kadastrale Komoran.

Neni 3

Me këtë vendim do të njoftohet NTSH."BE-INGENIERINBAU" me pronar Gëzim Gegaj nga Komorani.

Neni 4

Per zbatimin e këtij vendimi përkujdeset kryetari i Komunes, dhe Drejtoratet përkatëse të komunës së Drenasit.

Neni 5

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmerisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Labinot Halilaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



12 Nr 421/01-27093 dt. 11/05/2018

Duke u bazuar në nenin 11,12 dhe 40 pika 40.2 nën 1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40, nenit 34 pika 34,6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Ligjit mbi token ndërtimore, si dhe në bazë të Raportit Nr. 01-942/04-21953 të datës 18.04.2018 të komisionit profesional për verifikimin e procedurave ligjore të dhënies në shfrytëzim të pronave komunale, me pronar Hajdar Heta nga Gllogovci, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vetë të rregullt më datë 04.05.2018 aprovoi këtë:

V E N D I M

PËR KTHIMIN E PRONES KOMUNALE, TE DHENE NE SHFRYTEZIM TE PERHERSHEM PRONARIT HAJDAR HETA NGA GLLOGOVCI

Neni 1

Më këtë Vendim, miratohet Kthimi i Prones Komunale në Zonen Kadastrale në Çikatov të Re, që i ishte dhënë në shfrytëzim pronarit Hajdar Heta nga Gllogovci, në ngastrën kadastrale Nr.98/4 me kulture tokë ndërtimore në sipërfaqe prej S=0.04.50 ha në zonën kadastrale Çikatov e Re, në shfrytëzim të përhershëm .

Neni 2

Shfuqizohet Vendimi Nr.07-353-142 i datës 30.04.1993 , me të cilat vendim i është dhënë prona komunale në shfrytëzim të përhershëm pronarit Hajdar Heta nga Gllogovci, në ngastrën kadastrale Nr.98/4 me kulture tokë ndërtimore në sipërfaqe prej S=0.04.50 ha në zonën kadastrale Çikatov e Re.

Neni 3

Me kete vendim do te njoftohet pronari Hajdar Heta nga Gllogovci.

Neni 4

Per zbatimin e këtij vendimi përkujdeset kryetari i Komunes, dhe Drejtoratet përkatëse të komunës së Drenasit.

Neni 5

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmerisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Labinot Halilaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



12 Nr 42/01-2709/dt. 1525/ 2018

Duke u bazuar në nenin 11,12 dhe 40 pika 40.2 nën 1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40, nenit 34 pika 34,6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Ligjit mbi token ndërtimore, si dhe në bazë të Raportit Nr. 01-942/04-21953 të datës 18.04.2018 të komisionit profesional për verifikimin e procedurave ligjore të dhënies në shfrytëzim të pronave komunale, me pronar Zejnullah Strumcaku nga fshati Abri e Epërm, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vetë të rregullt më datë 04.05.2018 aprovoi këtë:

V E N D I M

PËR KTHIMIN E PRONES KOMUNALE, TE DHENE NE SHFRYTEZIM TE PERHERSHEM PRONARIT ZEJNULLAH STRUMCAKU NGA FSHATI ABRI E EPERME

Neni 1

Më këtë Vendim, miratohet Kthimi i Prones Komunale në Zonen Kadastrale në Çikatov të Re , që i ishte dhënë në shfrytëzim pronarit Zejnullah Strumcakut nga fshati Abri e Epërm, në ngastrën kadastrale Nr.98/3 me kulture tokë ndërtimore në sipërfaqe prej S=0.04.00 ha në zonën kadastrale Qikatov e Re, në shfrytëzim të përhershëm .

Neni 2

Shfuqizohet Vendimi Nr.07-353-180/1 i datës 14.10.1192, me të cilat vendim i është dhënë prona komunale në shfrytëzim të përhershëm pronarit Zejnullah Strumcaku nga Abria e Eperme, ngastrën kadastrale Nr.98/3 me kulture tokë ndërtimore në sipërfaqe prej S=0.40.00 ha në zonën kadastrale Çikatov e Re.

Neni 3


Me kete vendim do te njoftohet pronari Zejnullah Strumcaku nga fshati Abri e Eperme dhe tjetersuesi Qazim Gorani nga Pokleku.

Neni 4

Per zbatimin e këtij vendimi përkujdeset kryetari i Komunes, dhe Drejtoratet përkatëse të komunës së Drenasit.

Neni 5

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmerisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb-faqen zyrtare të Komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Labinot Halilaj



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E DRENASIT
KUVENDI I KOMUNËS

12 Nr. 52/25-27 dt. 11/05/2018
27101

Duke u bazuar në nenin 11,12 dhe 40 të Ligjit për vetqeverisjen locale nr. 03/L-040 , nenit 6 dhe 12 të Ligjit për dhenjën në shfrytëzim dhe kembimin e pronës se paluajtshme të Komunës nr. 04/L-144 (gaz. Zyrt. Nr. 35/2012) e Republikës se Kosovës ,nenit 34 pika 34.6 të Statutit të Komunës se Drenasit, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë 04.05.2018 aprovoi këtë:

V E N D I M

Për shpalljen e intersit të përgjithshem-publik për percaktimin e lokacionit të varrezave në fshatin Korroticë e Ultë

Neni 1

Me këtë vendim aprovet propozimi i Krytarit të Komunes së Drenasit për shpalljen e interesit të përgjithshem-publik të Komunës se Drenasit për pronën e paluajtshme mbrenda zonës kadastrale në Zabel të Ultë dhe Korroticë të Ultë e cila pronë do të percaktohet si lokacion për varreza të ketijë fshati.

Cakëtimi i këtij lokacioni është në pjesën e ngastrës kadastrale nr 522 me kulturë arë e kl 3,4,5- në vendin e quajtur // në sipërfaqe prej S=1.00.00 ha sipas aktvendimit të komasacionit nr.461-812 të dt. 30.09.1985 zona kadastrale. Zabel i Ultë e cila pronë është në emer të "Agroproduktit" dhe nen menagjim të AKP-es në Prishtinë.

Neni 2

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset kryetari i komunës që të benë iniciimin e procedurës se metejme procedurale për kthimin e pronës të pjesës se ngastrës kadastrale nr.522 në sipërfaqe prej S= 1.00.00 ha Z.kad.Zabel i Ultë në pronësi të Komunës se Drenasit, procedurën për kthim të pronës nga ish "Agroprodukti" me kërkesë zyrtare në organet e AKP-s në Prishtinë, dhe në Qeveri të Republikës se Kosovës për kthimin e kësaj sipërfaqëje toksore për nevojat e Komunës se Drenasit gjegjësisht për lokacion të varrezave të fshatit Korroticë e Ultë, zyra e kryetarit të Komunës i drejtohet ZVPP-es në kuader të Ministrisë se Financave – departamentit tatimit mbi pronë, për vlersimin e pronës.

Neni 3

Për zbatimin e këtij propozim vendimi do të kujdesët Kryetari i Komunës së Drenasit, ndërsa për bartjen administrative të pronës gjegjësisht regjistrimin në RDPP obligohet Drejtoria për Kadastrë Gjeodezi dhe Pronë.

Neni 4

Për rregullimin e rregullimit të terrenit në lokacionin e varrezave dhe thurjen e sipërfaqes së caktuar obligohet Drejtoria për shërbime publike.

Neni 5

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga data regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmerisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Labinot Halilaj



Duke e zbatuar vendimin e zyrës së Kryetarit të Komunës së Drenasit 01.nr.020-18040 të dt. 30.03.2018 me të cilin vendim është formuar komision profesional për verifikimin e procedurave ligjore të dhënjes së në shfrytëzim të pronave komunale. Komisioni në përberje të plotë pas verifikimit të procedurave administrative-ligjore paraqet këtë:

R A P O R T

MBI VLERSIMIN E ZBATUESHMERISË SE PROCEDURAVE LIGJORE PËR DHËNJEN E PRONAVE KOMUNALE NË SHFRYTËZIM DHE PERMBUSHJËS SE OBLIGIMEVE KONTRAKTUESE

Komisioni në përberje të plotë ka filluar me punë me datë: 03.04.2018 rreth vlersimit të procedurave për dhënjën e pronave komunale në shfrytëzim dhe zbatueshmerisë së kontratave të lidhura në mes të Komunës së Drenasit gjegjësisht Kryetarit të dhe atyre të cilët e kanë marrë pronën komunale në shfrytëzim, Komisioni duke bërë një punë efektive në terren dhe në zyrë për secilin rast veç e veç ka rezultuar me këto të dhëna në raport me shkrim.

Në zonën kadastrale në Komoranë ka verifikuar rastet si:

I. Kontratën për dhënjën e pronës komunale në shfrytëzim në mes të Komunës së Drenasit dhe NTSH, "BE-INGENIERINBAU" me pronar Gezim Gegaj nga Komorani e protokoluar nën numrin e protokollit 421-6064 të datës 06.07.2009

Në kontratë shifet se është e nënshkruar nga ish Kryetari i Komunës së Drenasit z. Nexhat Demaku dhe pronari i firmes Gezim Gegaj.

Komuna sipas kontratës së shënuar më lartë i ka dhënë në shfrytëzim pronën komunale gjegjësisht pjesët e ngatrës kad. Nr. 202 dhe 201 me kulturë tokë ndërtimore në sipërfaqe prej $S=0.40.00$ ha në vendin "Fusha e gjerë" në zonën kadastrale Komoranë në kohëzgjatje të shfrytëzimit prej 10 vitesh.

Sipas kontratës Gezim Gegaj ka pasur për obligim ndërtimin e objektit brenda një viti për punë në veprimtarin për të cilën e ka marrë edhe tokën në shfrytëzim

Sipas kontratës pronari Gezim Gegaj ka pasur për obligim që të i paguaj komunës qeran në shumë vjetore 8000 euro në çdo fund vit.

Sipas të dhënave në Operat kadastral kjo kontratë nuk është e rexhistruar fare në RDPP, pastaj sipas të dhënave nga Drejtoria për financa, Gezim Gegaj nuk ka paguar asnjëherë obligimet të cilat i ka pasur sipas kontratës. Ndaj Komunës.

Në tërën nga ekspertet e gjeodezisë janë bërë matjet gjeodezike dhe nga ana e komisioni komunal shifet se është i ndertuar vetëm një objekt i thjeshtë në të cilin punohet për dyrë e dritare plastike, dhe një pjesë aneks në të cilin është një autolarje, (me një pjesë të vogël uzurpimi të rrugës $S=0.00.23$ ha dhe një sipërfaqe toksore e mbushur sipas pronarit për fushë sportive por e pa perfunduar.

Nuk ka kurrfarë leje të ndërtimit për atë vend ku zhvillon veprimtarinë.

Nga komisioni konstatohet se pronari i kësaj firme e nuk i ka përmbushur obligimet kontraktuese sipas kontratës ndaj Komunes së Drenasit në asnjë aspekt prandaj i rekomandon zyrës së Kryetarit të Komunes që në harmoni me ligjet në fuqi të ndërmarrë masat e duhura për anulimin e kësaj kontrate dhe që ta obligoj pronarin që sipërfaqën e pronës komunale të cilën e ka marrë në shfrytëzim ta kthejë në gjendjen e mëparshme dhe ta liroj mbrenda afatit prej 60 ditësh.

II .Kontrata për dhënjën e pronës komunale në shfrytëzim e lidhur në mes të ish kryetarit të Komunes së Drenasit z.nexhat Demakut dhe pronarit të firmës NTP"Floriani" Muhamet Ajazit e protokoluar në numrin 462-4010 me dt. 06.07.2009

Me këtë kontratë i është dhënë në shfrytëzim prona komunale Muhamet Ajazit nga Komoran gjegjësisht ngastra kadastrale nr. 1/6 me kulturë tokë ndërtimore në sipërfaqe prej $S=0.10.00$ ha

Zona kadastrale Komoran në shfrytëzim për 10 vite.

Pas inqizimit gjeodezik nga ekspertet dhe verifikimit nga ana e komisioni profesional të komunes në terren shifet se Muhamet Ajazi ka ndërtuar një objekt për dhënjë dhe nuk ka vazhduar më tej. Nuk ka as leje ndërtimi dhe inspeksioni ka intervenuar për ndërprerje të punimeve në objekt përderisa ska leje ndërtimi. Gjithashtu konstatohet se në hyrje të ngastres ka edhe një pjesë uzurpimi në sipërfaqe prej $S=0.00.71$ ha.

Sipas të dhënave nga Drejtoria për financa del se i permenduri i ka kryer obligimet financiare ndaj komunes deri në vitin 2017, gjersa në kontratë shkruan se obligohet të ia paguaj nga 2000 euro për çdo vit kalendarik Komunës.

Sipas kontratës i permenduri është dashur ta perfundojë objektin për të cilin ka deklaruar se po e bënë për afarizëm, por fatkeqsisht nuk e ka ndërtuar mbrenda afatit (për një vit).

Rexhistrimin në RDPP e ka bërë dhe e ka Qertifikatën mbi të drejtat e shfrytëzimit të pronës komunale. Nga komisioni konstatohet se pronari i kësaj firme e nuk i ka përmbushur obligimet kontraktuese sipas kontratës ndaj Komunes së Drenasit në asnjë aspekt prandaj i rekomandon zyrës së Kryetarit të Komunes që në harmoni me ligjet në fuqi të ndërmarrë masat e duhura për anulimin e kësaj kontrate dhe që ta obligoj pronarin që sipërfaqën e pronës komunale të cilën e ka marrë në shfrytëzim ta kthejë në gjendjen e mëparshme dhe ta liroj mbrenda afatit prej 60 ditësh.

Gjithashtu komisioni konstatoj nga raporti i mëparshëm të protokoluar 01.nr.463/15202 të datës 15.03.2018 se janë edhe dy raste tjera të dhënjës së pronës komunale në shfrytëzim personave fizikë si: Hajdar Hetës dhe Zenë Strumcakut -Qazim Goranit sipas tekstit në vijim.

III. Komisioni vazhdoi me trajtimin e procedurave ligjore dhe dokumentacionit për ngastrat kadastrale nr. 98/3 dhe 98/4 të zona kadastrale Qikatova e Re.

-Në dokumentacionin e fotokopiuar për ngastrën kadastrale nr.98/3 kemi Aktvendimin 07.nr.353/180/1 të dt.14.10.1992 (vendim i masave të dhunshme të Serbisë)me të cilin i është dhënë prona komunale (për ndertim individual të objektit) në sipërfaqe prej $s=0.04.00$ ha në Z. kad. Qikatova e Re.Zejnullah Strumcakut ngaq fshati Abri e Epër.

-Pastaj Kontrata për shitblerjen e këtij trolli në sipërfaqe prej $S=0.04.00$ ha e lidhur në mes të Zejnullah Strumcakut (shitës) dhe Qazim Goranit nga Pokleku (blerës) e cila kontratë edhe është e vertetuar në Gjykatën komunale në Prishtinë nën numrin 1654 të dt. 14.08.2000

-Aktvendimi i Drejtoratit për Kadaster Gjeodezi dhe Pronë i Komunës së Drenasit nr.952/26 i dt. 08.03.2005, me të cilin aktvendim i është refuzuar kërkesa për rëxhistrim në RDPP të këtijë truelli,me arsyetim se nuk ka pasur të drejt të tjetërsimit të pronës nga Zejnullah Strumcaku në emër të Qazim Goranit.

- Aktvendimin nr.03/224/09 të dt.29.04.2009 me të cilin AKK Ja në Prishtinë ia aprovon ankesën dhe e detyron Drejtorinë për Kadaster Gjeodezi dhe Pronë të Komunës së Drenasit që ta rëxhistron këtë truall në emër të Qazim Goranit.

- Pasi që Komuna nuk e ka zbatuar detyrimin për regjistrim të asaj ngastre-trualli,AKK në Prishtinë me Aktvendimin nr. 03/824/09 të dt. 02.02.2011 ka bërë ekzekutimin e aktvendimit të vetë me nr. 03/224/09 të dt. 29.04.2009 dhe e ka rëxhistruar vetë drejtperdrejt truallin në emër të Qazim Goranit nga Pokleku nga Pokleku.

-Me vonë Drejtorati për kadaster Gjeodezi dhe Pronë i Komunës së Drenasit ka bërë azhurimin e në RDPP me datë 15.07.2015 dhe e ka lëshuar Qertifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme dhe atë si (lloj i pronës -pronë private) në emër të Qazim Goranit dhe aty ku është i shënuar emri, është shfrytëzues i përhershëm.

Komisioni konstaton se procedura administrative ka parregullsi dhe përkunder asaj që Drejtorati për kad. Gjeod. dhe pronë ia ka refuzuar kërkesën për rëxhistrim në RDPP.

Kur themi se ka parregullsi, vejmë në pah se ngastra kadastrale e shënuar në emër të Qazim Goranit nuk ka mundur të tjetërsohet nga Zejnullah Strumcaku si shitës.

Prap edhe pse AKK në Prishtinë e ka futur në system na nuk mund ta hjekim nga sistemi por i përmenduri sipas dispozitave në arsyetim të Aktvendimit të ZKK-Drenas del se e ka humbur të drejtën e ndërtimit ngase atë kusht të ndërtimit është dashur ta përmbush mbrenda tri vitesh.

Ndërsa të rëxhistrimi i ngastrës kadastrale nr. 98/4 në emër të Hajdar Hetës komisioni gjatë procedimit të kësaj lënde trajtoj komplet dokumentacionin që nga fillimi duke vlersuar procedurën e ndarjës dhe rëxhistrimit në RDPP të ngastrës kad. Nr. 98/4.

-Komisioni në fillim konstatoi se kjo ngastër kadastrla me aktvendimin 07.nr.353-142 të dt. 30.04.1993 l'është ndar në shfrytëzim të perhershëm ngastra kad. Nr. 98/4 në sipërfaqe prej $S=0.04.50$ ha e shënuar më lartë Hajdar Hetës nga Drenasi (në kohën e masave të dhunshme të Serbisë).

Me vonë me aktvendimin 07.nr.351-209 të dt. 12.07.1993 l'ipet leja për ndertimin e objektit në atë vend gjegjësisht në truallin-ngastrën kad. Nr.98/4 në Qikatovë të Re.

-Mer aktvendimin nr.,952/290 të dt. 19.10.2005 nga Drejtoria për Kadaster Gjeodezi dhe Pronë l' rrefuzohët kërkesa për rexhistrimin e këtijë trualli në emer të Hajdar Hetës.

-Hajdar Heta ka vazhduar me ankesë në AKK në Prishtinë dhe AKK-ja me konkluzionin nr.03/879/09 të dt.879/09 të dt.1.07.09 e urdhëron Drejtoratin për Kad. Gjeod. dhe Pronë që ta vendos kërkesën e Hajdar Hetës në procedurë ligjore.

-Me Aktgjykimin e Gjykatës themelore në Prishtinë –departamenti për qeshtje administrative nr. 986/2009 të dt. 11.06.2013 është rrefuzuar kërkesëpadia e Komunës së Drenasit e cila e ka paditur AKK-n në Prishtinë për këtë regjistrim të kësaj pronë.

-Pas rexhistrimit në RDPP të kësaj prone në emer të Hajdar Hetës nga Drenasi, me Qertifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme të azhuruar me datë 15.07.2015 e ka nxjerr nga Drejtoria për kad. Gjeod. dhe Pronë Qertifikata e pronës në emer të Hajdar Hetës jo si shfrytëzues l' perhershëm l' pronës komunale por si lloj l' pronës privat.

Komisioni konstaton se procedura administrative lidhur me këtë ngastër kadastrale ka parregullsi edhe pse Drejtoria për kadaster gjeodezi dhe Pronë ia ka rrefuzuar rexhistrimin e pronës së H.Hetës në RDPP.

Kur themi se ka parregullsi rreth zbatimit të ligjshmerisë për këtë truall nga se Hajdar Heta e ka marrë në kohën e masave të dhunshme, edhe Lejen e ndertimit të objektit ,por l' njejtë nuk ka ndertuar kurr,e që është në kundërshtim me ligj sepse pas kalimit të afatit prej tre vjetësh nese nuk ka bërë ndertim në atë vend e ka humbur të drejtën e ndertimit (kur edhe e ka pas lejen e ndertimit nga organi l' dhunshëm),por që nuk e ka shfrytëzuar.

Komisioni konstaton se pronat e dhëna në shfrytëzim të perhershëm për Hajdar Hetën dhe Zenë Strimcakun e që me vonë është bërë edhe tjetërsimi l'pronës komunale nga Zenë Strimcaku të Qazim Gorani,ka shkelje të dispozitave ligjore, andaj komisioni lidhur me parregullsitë e rexhistrimit të ngastrës nr.98/3 dhe 98/4 z.kad.Qikatovë e Re l' rekomandon zyrës së Kryetarit që të ndermerr veprimet ligjore për kthimin e e ketyre dy ngastrave kadastrale në emer të Komunës së Drenasit.

DRENAS :18.04.2018

KOMISIONI:1.Halim Prokshi_____

2.Ibrahim Hajdari_____

3.Safet Hoxha_____

4.Flora Thaqi_____

5.Enver Hoxha_____



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



012 Nr - 030/01 dt. 11. 05. 2018
- 00 27/08

Duke u bazuar në nenin 11,12 dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40, nenit 34 pika 34.6 nënpika f të Statutit të komunës, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me date 04.05.2018 aprovoi këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit për përgatitjen e Rregullores për Dekorata dhe Mirënjohje në Komunën e Drenasit

Neni 1

Më këtë Vendim formohet Komisioni për përgatitjen e Rregullores për Dekorata dhe Mirënjohje në Komunën e Drenasit në përbërje prej shtatë (6) anëtarëve, të cilin Komision e përbejnë tre (3) anëtar nga Ekzekutivi i Komunës të cilët i propozon Kryetari i Komunës, tre (3) anëtar nga Kuvendi i Komunës nga subjektet e ndryshme të përfaqësuar në Kuvend si vijon:

1. Gani Sylaj - anëtar nga ekzekutivi
2. Flutura Avdiu - anëtar nga ekzekutivi
3. Shukrie Rama – anëtar nga ekzekutivi
4. Arta Xhylani – anëtar nga kuvendi
5. Vehbi Berisha - anëtar nga kuvendi
6. Beqir Kiqina - anëtar nga kuvendi

Neni 2

Komisioni ka për detyrë të bëjë përgatitjen e Rregullores për Dekorata dhe Mirënjohje në Komunën e Drenasit, duke pasur për bazë legjislacionin në fuqi që rregullon këtë çështje. Komisioni për përgatitjen e Rregullores për Dekorata dhe Mirënjohje, punën e tyre duhet ta kryejnë me profesionalizëm të lart dhe përkushtim

Neni 3


Komisioni për përgatitjen e Rregullores për Dekorata dhe Mirënjohje në Komunën e Drenasit, i dërgon Kuvendit të Komunës për aprovim këtë rregullore, pas përfundimit të gjitha procedurave të parapara me ligj.

Neni 4

Mandati i këtij komisioni vazhdon deri në aprovimin e kësaj rregullore nga ana e Kuvendit të Komunës së Drenasit.

Neni 5

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmerisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

 **Kryesuesi i Kuvendit të Komunës**

Sabir Hoti Halilaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



1612 Nr *22.062-27079* dt. *11/05/2018*

Duke u bazuar në nenin 11,12 dhe 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40, nenit 34 pika 34.6 nënpika f të Statutit të komunës, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me date 04.05.2018 aprovoi këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit për ndryshimin e Stëmës dhe Vulës së Komunës së Drenasit si dhe harmonizimin e statutit të komunës me ligjet në fuqi

Neni 1

Më këtë Vendim formohet Komisioni për ndryshimin e Stëmës dhe Vulës së Komunës së Drenasit në përbërje prej shtatë (7) anëtarëve, të cilin Komision e përbejnë tre (3) anëtar nga Ekzekutivi i Komunës të cilët i propozon Kryetari i Komunës, tre (3) anëtar nga Kuvendi i Komunës nga subjektet e ndryshme të përfaqësuar në Kuvend, dhe një (1) anëtar nga shoqëria civile i propozuar nga Kryetari i Komunës si vijon:

1. Bekim Morina - anëtar nga ekzekutivi
2. Flamur Curri - anëtar nga ekzekutivi
3. Shqipe Kuliqi -- anëtar nga ekzekutivi
4. Shqipe Zogu - anëtar nga kuvendi
5. Bedri Nika - anëtar nga kuvendi
6. Petrit Sinani - anëtar nga kuvendi dhe
7. Ylber Haxhiu - përfaqësues nga shoqëria civile, anëtar,

Neni 2

Komisioni ka për detyrë të bëjë propozimin e ndryshimit të Stëmës dhe Vulës së Komunës së Drenasit, duke respektuar procedurat e parapara ligjore.

Komisioni për ndryshimin e Stëmës dhe Vulës së Komunës së Drenasit, punën e tyre duhet ta kryejnë me profesionalizëm të lart dhe përkushtim.

Neni 3

Komisioni për ndryshimin e Stemës dhe Vulës së Komunës së Drenasit, i dërgon Kuvendit të Komunës për aprovim këto ndryshime, pas përfundimit të gjitha procedurave të parapara me ligj.

Neni 4

Mandati i këtij komisioni vazhdon deri në aprovimin e këtyre ndryshimeve nga ana e Kuvendit të Komunës së Drenasit.

Neni 5

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmerisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Labirnot Halilaj



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës



012 Nr 600/09-27080 dt. 11/05/ 2018

Duke u bazuar në nenin 11, 12 dhe 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 34. pika 34.6 të Statutit të Komunës së Drenasit, Rregullores për caktimin e kritereve për ndarjen e Subvencioneve dhe Transfereve të miratuar me datë 19.03.2017 nga Kuvendi Komunal Drenas Nr. 12-320-19338, pastaj Buxheti i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Drenasit për vitin 2018, si dhe në bazë të kërkesës Nr. 06-400-15744 të datës 19/03/2018 për përkrahjen e projektit të Qendrës së RBB-së "Handikos"-Drenas, sipas shpalljes publike datë 14/03/2018 Nr. 06-400-14795 të DSHMS, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë 04.05.2018 aprovoi këtë:

VENDIM
PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TË HANDIKOS-it

Neni 1

Me këtë vendim, kërkohet mbështetja financiare Qendrës për Rehabilitim të bazuar në Bashkësi "HANDIKOS" dega në Drenas për realizimin e projektit "Përkrahja e Shërbimeve Rehabilituese në bashkësi për fëmijë dhe të rritur me aftësi të kufizuar" lidhur me mbulimin e shpenzimeve për vitin 2018,

Neni 2

Realizimi i Projektit të Qendrës së RBB-së "Handikos" dega në Drenas, të përkrahët me shumën prej 5.000 Euro mjete të cilat do të shfrytëzohen për mbulimin e shpenzimeve për vitin 2018.

Neni 3

Financimi-Subvencionimi i projektit do të bëhet nga Buxheti i DSHMS nga kategoria ekonomike e shpenzimeve, subvencioneve dhe transfereve, kodi ekonomik 21/611/73010/21200/0760.

Neni 4

Mjetet financiare barten në konton e "Handikosit" NLB Bank në numrin e llogarisë 17010016000945.60. Drejtorati i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale është e obliguar që për shumën e mjeteve për financimin e përmendur në nenin 2 të këtij propozimi vendimi të përcjellë implementimin e projektit, duke kërkuar nga "Handikos" që të bëjë raport tekstual dhe financiar në mënyrë që të njoftojë DSHMS për mënyrën e shpenzimeve të mjeteve financiare.

Neni 5

Ky vendim hynë në fuqi ditën e aprovimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Drenasit, për zbatimin e tij do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtorati për Buxhet dhe Financa dhe Drejtorati për Shëndetësi e Mirëqenie Sociale.

Neni 6

Ky Vendim hynë në fuqi 15 ditë nga dita regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmerisë nga MAPL-ja si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

 Kryetari i Kuvendit të Komunës
Labinot Halilaj